



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Pranuar - Prizano MeDana 22-05-2012			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shprehje Prilog	Vlera Vrednosit
01-013/640			

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika l të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 16.05.2012, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E MONUMENTIT PËRKUJTIMOR PËR SAHIT GORANI, ZUKË ZUKA DHE BALË AHMETI NË NGASTRËN KADASTRALE 1090-2 Z.K. GËRMOVË

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton lokacionin për ndërtimin e monumentit përkujtimor për Sahit Gorani, Zukë Zuka dhe Balë Ahmeti të rënë në vitin 1912 te Rogat e Sojevës në luftë me pushtuesin serb.

Neni 2

Vendi – lokacioni për ndërtimin e monumentit përkujtimor caktohet në Zonën Kadastrale Gërmovë, në këndin e djathtë të rrugës Gërmovë - Smirë dhe në anën e majtë të rrugës Viti - Gërmovë- Gerlicë, në ngastren kadastrale nr 1090-2 në pronësi P.SH. Komuna e Vitisë e cila ka një sipërfaqe prej 988 m² me dimensione të ofruara nga Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Ndarja e lokacionit bëhet në bazë të kërkesës së Këshillit të fshatit Gërmovë, me numër 07-07/500 të datës 25.04.2012.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Këshillit të fshatit Gërmovë,
2. Drejtorisë për Kadastër,
3. Drejtorisë për Kulturë,
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi

